



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-023

Prishtinë, më 15 dhjetor 2021, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2021

**Në mbledhje morën pjesë:** Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Në fillim, kryetari e uroi z. Enver Hoxhaj për zgjedhjen e tij në pozitën e nënkryetarit të Kuvendit.

Pastaj, me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

### **1. Shqyrtimi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, e nënshkruar nga 46 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 46 deputetë të Kuvendit kanë kërkuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës të mbajë seancë të jashtëzakonshme, të premtën, më 17 dhjetor 2021, në orë 11:00, me pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Ai tha se në nenin 69, paragrafi 4 i Kushtetutës, është e përcaktuar se Kuvendi mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Presidentit, Kryeministrit, ose së paku 40 deputetëve.

Pastaj kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, në emër të 46 deputetëve parashtrues e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për seancë të jashtëzakonshme, diskutimi i të cilës është dhënë në transkript.

Më pas, në lidhje me kërkesën e lartshënuar për seancë të jashtëzakonshme dhe për çështjen se Kuvendi më parë ka vendosur që më 22 dhjetor 2021 të mbahet seancë plenare për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca; nënkryetarët e Kuvendit, Kujtim Shala dhe Enver Hoxhaj; kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, dhe kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartpërmendura, Kryesia vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit, sipas kërkesës së 46 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të mbahet të premtën, më 17 dhjetor 2021, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

*1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.*

\* \* \*

Në vazhdim, kryetari z. Konjufca i njoftoi të pranishmit se Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Vjosa Osmani - Sadriu, i është drejtuar me shkresë të re Kuvendit, e cila kërkon që adresimi i saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i caktuar për datën 22 dhjetor 2021, në orën 10:00, të zhvendoset për datën 17 dhjetor 2021, në orën 10:00.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia, në lidhje me adresimin e Presidentes deputetëve të Kuvendit, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të premtën, më 17 dhjetor 2021, në orën 10:00, me këtë:

#### Rend dite

*1. Adresimi i Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës.*

\* \* \*

Po ashtu, Kryesia me propozim të kryetarit z. Konjufca vendosi që vazhdimi i seancës plenare, të mbajtur më 25, 26 nëntor dhe 6 dhjetor 2021, me pikat e papërfunduara të mbahet të premtën, më 17 dhjetor 2021, në orën 18:00, me këtë:

#### Rend dite

*5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-067 për inspektimet,*

*6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-065 për produktet biocide,*

*9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2020.*

\* \* \*

Në fund, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, e shtroi çështjen e rëndësisë së ratifikimit të dy marrëveshjeve ndërkombëtare të proceduara nga Qeveria në Kuvendit: “Hearizing Europe” dhe “Creative Europe”, para se Kuvendi t’i fillojë pushimet e sesionit, diskutimi i plotë i të cilës është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 16:45 minuta.

Glauk KONJUFCA

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*